



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.12.2019 ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim teknik 2018, për projektin “Menaxhimi i modernizuar i mbetjeve dhe ekonomia ricikluese në respekt të mjedisit (DKTI)”
2. Projektligji "Për ratifikimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë (Këshilli i Ministrave) dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për programin e shkëmbimit akademik “Fulbright”
3. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2018 për projektin “Programi për Infrastrukturën Komunale V””

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Ralf Gjoni, Vasil Sterjovski, Andrea Marto, Ligoraq Karamelo, Ediola Braha, Zef Shtjefni, Eglantina Gjermeni, Adnor Shameti, Halit Valteri, Reme Lala, Evis Kushi, Ervin Bushati, Bashkim Fino dhe Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Vasilika Hysi, Elona Hoxha, Rudina Hajdari, Ditmir Bushati dhe Fatmir Velaj.

Të ftuar:

Blendi Klosi – Ministër i Turizmit dhe Mjedisit

Adrian Kamenica – Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit

Redi Baduni – Drejtor i Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve në Mjedis

Kostandin Shkurti – Zëvendësministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Erzen Tola – Drejtor i Përgjithshëm Rregullator dhe i Përputhshmërisë në Ministrinë
për Arsimin, Sportin dhe Rininë

Jovan Gjika – Drejtor i projekteve të KfW-së

Lindita Sotiri – Drejtoreshë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita!

Përpara se të fillojmë me diskutimin e projektligjeve që kemi në rendin e ditës, duhet të kërkoj mirëkuptimin tuaj për miratimin e kalendarit 3-mujor të punimeve deri më datë 20 dhjetor. Ka pasur një shtesë në disa projektligje që është e nevojshme të diskutohen, për ratifikimet e marrëveshjeve ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, qeverisë Gjermane dhe Shteteve të Bashkuara lidhur me tri projekte.

E ndiej për detyrë të sqaroj që këto projektligje nuk janë vonuar nga qeveria, sepse janë depozituar me kohë në parlament, por administrata e parlamentit nuk i ka sjellë. Kjo është për sqarim. Pra, kjo vonesë buron nga ne dhe jo nga qeveria, pastaj është për t'u parë se përse janë vonuar, meqenëse kemi edhe përfaqësuesit e qeverisë.

Këtyre marrëveshjeve u skadon afati dhe u digjen fondet, prandaj dua që me mirëkuptimin tuaj ta miratojmë kalendarin. A jeni dakord me këtë gjë? Ju falënderoj dhe e konsideroj të miratuar kalendarin.

Faleminderit!

Vazhdojmë me rendin e ditës. Në rend të ditës kemi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik të vitit 2018, për projektin “Menaxhimi i modernizuar i mbetjeve dhe ekonomia ricikluese në respekt të mjedisit, DKTI””. Ne jemi komision për dhënie mendimi.

Sot na ka nderuar me prezencën e tij, kolegu Klosi, ministri i Turizmit dhe i Mjedisit. Mirë se vjen, zoti Ministër!

Kemi zotin Kamenica, sekretar i Përgjithshëm, dhe zotin Baduni, drejtor në Drejtorinë e Konceptit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Mjedisit.

Mirë se vini!

Fjala është për ju, zoti Ministër!

Blendi Klosi – E nderuara kryetare, faleminderit për mundësinë që na dhatë për t'u shprehur për këtë projektligj, që është sjellë në parlament për të marrë miratimin e tij, pas një punë shumë të gjatë që është bërë për negocimin e kësaj kontrate.

Kooperacioni gjerman, nëpërmjet GIZ-it, i ka ofruar qeverisë shqiptare në disa vite asistencë teknike, mbase mbi një dekadë. Projekti që miratojmë sot është në fazën e tretë të një kontrate të miratuar ndërmjet qeverisë shqiptare dhe asaj gjermane për këtë mbështetje.

Gjej rastin të falënderojmë donatorët gjermanë, të cilët përsëri kanë pranuar që në projektet e tyre të jetë çështja e mjedisit si një çështje shumë e rëndësishme.

Nga vetë emri i marrëveshjes “Menaxhimi i modernizuar i mbetjeve dhe ekonomia ricikluese në respekt të mjedisit”, kuptohet që qëllimi i këtij aktiviteti do të jetë në tri aspekte. Së pari, në forcimin e kapaciteteve të Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit për të zbatuar strategjinë për menaxhimin e mbetjeve të ngurta, si dhe përputhshmëria dhe standardizimi i legjislacionit në fushën e mbetjeve dhe asistencë që do të japë ky koperacion për të forcuar Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, në nivelin qendror dhe lokal. Ajo që është më e rëndësishme për t’u theksuar është se për herë të parë, mbas negociatave jo shumë të thjeshta me kolegët gjermanë, ne kemi futur në këtë projekt edhe investime konkrete, që kanë të bëjnë me rehabilitimin e 6 landfilleve të vogla në bashkitë e nivelit të dytë, duke kërkuar që së bashku me të gjithë donatorët e tjerë, kjo është një nga sfidat e ministrisë për vitin 2020, të kemi mundësi që me donatorët të zgjidhim përfundimisht sistemin e trajtimit të mbetjeve urbane për bashkitë, për ta licencuar atë, për ta stabilizuar dhe për të pasur në 61 bashkitë e vendit një sistem, i cili vjen jo vetëm nëpërmjet menaxhimit të zonave të trajtimit të mbetjeve, që janë landfille plus incinerator, por të kemi edhe bashkitë e nivelit të dytë me një sistem legal të trajtimit të mbetjeve urbane. Unë besoj se këto projekte do të na ndihmojnë, të paktën për 6 bashkitë siç kemi rënë dakord, që të ketë investime konkrete për rehabilitimin e këtyre pikave në nivelin e dytë dhe pastaj për të shkuar në nivelin e parë në kuadër të zonave të trajtimit të mbetjeve, që është realizuar në të gjithë vendin. Pra rezultatet ne i presim në disa aspekte, e para është ajo e përafrimit të legjislacionit dhe këshillimit teknik për bashkitë, janë 6 bashki me nënkontraktim nga GIZ-i, por nuk do të marrin investime, pasi do të bëhet një master plan me të gjithë donatorët e tjerë.

GIZ-i ka nënshkruar marrëveshje me 6 bashki, që janë: Himara, Rrogozhina, Cërriku, Peqini, Roskoveci dhe Saranda. Pra janë 6 bashki të zgjedhura, të cilat do të kenë ndihmesë nga projekti për trajtimin e mbetjeve urbane, me sistemin e mbështetjes së vazhdueshme për sa u përket të gjithë mekanizmave të nevojshëm nga pikëpamja ligjore dhe administrative, por edhe nga ajo strukturore, pra me mjete të nevojshme për trajtimin e mbetjeve në këto 6 bashki.

Në të ardhmen, ekspertët do të përcaktojnë se ku do të trajtohen depozitimet e mbetjeve urbane, për t’i shndërruar ato në vende me depozitime legale, me kushtet minimale për të pasur leje nga bashkitë dhe për të përfutur lejen mjedisore.

Dua t’ju rikujtoj për komisionin, por edhe gjatë diskutimit në parlament, që ne kemi një problem të madh për sa u përket mbetjeve urbane në bashkitë e nivelit të dytë, por dhe ato

të nivelit të parë, pasi ajo që ka ndodhur me reformën e decentralizimit dhe me reformën e madhe territoriale që ne ndërmorëm, krijuam 61 bashki nga 400 njësi bashkiake që kemi pasur komuna dhe bashki, nuk është shoqëruar me zgjidhjen përfundimtare të problematikave të këtyre komunave.

Në fakt, tërmeti na ndërpreu një punë të madhe që ne kishim ndërmarrë me bashkitë, por do ta vazhdojmë menjëherë sa të stabilizohet situata, për të diskutuar qartazi me 61 kryetarët e bashkive dhe me këshillat bashkiakë, sepse ka ardhur koha që të kemi një trajtim tjetër të mbetjeve urbane, pasi në shumicën e rasteve, pothuajse në të gjithë territorin e vendit, kemi problematika shumë të mëdha.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Ministër!

Realisht ju falënderoj për atë çfarë thatë dhe për seriozitetin me të cilin keni paraqitur këtë projekt marrëveshje. E kuptoj çështjen e përpunimit të mbetjeve dhe rritjes së cilësisë së mjedisit si një prioritet kombëtar, por edhe botëror.

Ftoj kolegët të bëjnë pyetje apo diskutime, ndërkohë që në fund të pyetjeve ruaj të drejtën t'ju pyes edhe unë.

Kush e do fjalën? Fjalën e ka zoti Gjoni.

Ralf Gjoni – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti Ministër!

Unë kam dy pyetje. Çfarë ka ndodhur me fazat e mëparshme të programit? A mund të na informoni konkretisht me vendndodhjet Berat, Kuçovë, Gjirokastrë, Kamëz dhe Lushnjë, sipas qëllimit të projektligjit shpjegohet që kanë qenë pjesë e fazave të mëparshme 1, 2, 3 dhe 4 të programit, ndërkohë që Lezha, Fieri dhe Saranda kanë qenë pjesë e fazave 1 dhe 2 të programit? Pra çfarë ka ndodhur konkretisht dhe çfarë rezultatesh të prekshme janë arritur për qytetarët e këtyre vendndodhjeve?

Pyetja e dytë, ndoshta jam i painformuar lidhur me këtë, por më bën përshtypje që Tirana, e cila ka një të tretën e popullsisë së Shqipërisë dhe ndoshta është qyteti më problematik për sa i përket ujit të pijshëm, pra është i vetmi qytet në Shqipëri ku qytetarët paguajnë emërtimin “ujë i pijshëm” por në realitet nuk kanë ujë të pijshëm në shtëpi...

(Ndërhyrje pa informacion)

Ju kërkoj ndjesë, sepse lexova relacionin e gabuar dhe e tërheq pyetjen.

Faleminderit, zoti Fino!

Mimi Kodheli – Fjalën e ka zonja Gjermani!

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti Ministër!

Edhe unë e vlerësoj angazhimin dhe prezantimin tuaj në komision, në fakt, si gjithmonë në të gjitha komisionet e parlamentit. Gjithashtu, vlerësoj ndihmën e jashtëzakonshme që qeveria gjermane ka dhënë historikisht për zhvillimin tonë, edhe për projekte specifike infrastrukturore apo të zhvillimit në përgjithësi dhe në fushën e mbetjeve. Me sa di unë, pjesa e parë ka qenë harta digjitale dhe identifikimi i landfilleve apo e sipërfaqeve në të gjitha bashkitë që merren me mbetjet urbane. Unë dua t'ju pyes lidhur me marrëveshjen e zbatimit që do të lidhet me GIZ-in, pra kur pritet të lidhet dhe kur fillon zbatimi i kësaj marrëveshjeje, duke presupozuar që javën tjetër ne do ta miratojmë në parlament? E di që kohëzgjatja është tre vjet, por kur fillon ky proces?

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Fjalën e ka zoti Fino.

Bashkim Fino – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë dua të bëj një sugjerim dhe një pyetje. Marrëveshja që vjen vërtet është e KFW-së gjermane, por nuk ka lidhje me marrëveshjen e parë. Marrëveshja e parë ka të bëjë me disa bashki për problemin e ujësjellësit dhe kanalizimit. Kjo marrëveshje ka të bëjë me një marrëveshje të dytë, me ministrin Klosi, për mbetjet urbane. Pra, ne diskutojmë sot për 4 – 5 milionëshin që do të marrim si kredi e butë dhe do të votojmë nëse do ta marrim apo jo. Më fal për sqarimin, por e bëra për ata që nuk e kanë parë si material.

Pyetja ime është: zoti Ministër, me këto 4 – 5 milionë euro që marrim a e mbyllim ciklin e mbetjeve urbane në këto 6 bashkitë që sapa i cilësuar? Pra nuk janë pak 6 nga 61 bashki, kështu do të vazhdojmë hap pas hapi.

Faleminderit, kryetare!

Mimi Kodheli – Fjalën e ka zoti Sterovski. Pastaj e ka zoti Karamelo.

Vasil Sterovski – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë e mbështes këtë marrëveshje, por kisha një kërkesë për ministrin, që në marrëveshjet e ardhshme ministria të përfshijë edhe Bashkinë e Pustecit, që, siç e dini, është pjesë e Parkut Kombëtar të Prespës, pra është zonë e mbrojtur turistike, por nuk ka kapacitetet e nevojshme që të menaxhojë mbetjet urbane. Për këtë është përcaktuar që mbetjet urbane të çohen në Bashkinë e Maliqit, që është 40 kilometra larg nga qendra e bashkisë, por bashkia nuk i ka mundësitë t'i çojë mbetjet urbane në Bashkinë e Maliqit, prandaj duhet një mbështetje për organizimin e tyre me ndonjë makinë. Pra, kërkesa ime është që në projektet e ardhshme të përfshihet edhe Bashkia e Pustecit.

Faleminderit!

Ligoraq Karamelo – Faleminderit, zonja kryetare!

I nderuar zoti Ministër,

Të nderuar kolegë,

Edhe unë dua të shpreh mbështetjen time për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje, natyrisht që është një marrëveshje që prek një nga sektorët më problematikë dhe më të ndjeshëm të vendit tonë, siç është problemi i mjedisit. Në këtë drejtim ne shikojmë që për mjedisin vijnë projekte dhe bëhen investime, me efektivitet ose pa efektivitet, por unë dua të di, së pari, me këto lekë që do të vijnë për të kryer studimet, a i hapin dritën jeshile mbështetjes financiare nga ana e qeverisë apo do të priten përsëri donatorë për të kaluar në zbatimin konkret për ndërtimin e këtyre landfillleve?

Gjithashtu, zoti Ministër dua të di nga 61 bashki, sa landfillle ka që janë funksionale, sepse në këtë drejtim më duket se janë bërë disa hapa, por rezultatet konkrete ndoshta janë larg.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Fjala për ju, zoti Ministër.

Blendi Klosi – Të nderuar kolegë, duke vlerësuar katër grupet e pyetjeve tuaja, realisht, është i gjithë procesi që ne do të ndërmarrim në stabilizimin dhe trajtimin e mbetjeve urbane në vend. Për informacion, Shqipëria tashmë ka investime të qenësishme në disa landfillle të mëdha, të cilat janë në rajonet e trajtimit të mbetjeve, pastaj edhe bashkitë e nivelit të dytë në të gjithë institucionet e pushtetit lokal, qoftë edhe ish-njësitë që janë në këtë fazë, pra edhe pa trajtimin e duhur, do të duhet të shkojnë drejt landfillleve të mëdha.

Këtu vjen edhe përgjigjja për pyetjen e zonjës Gjermani se kur do të fillojë ky proces. Duke analizuar bashkitë, të cilat do të kenë trajtimin e mbetjeve urbane në kapacitetet e tyre, do të jenë 6 bashki të zgjedhura nga ky projekt për t'u krijuar mundësi që trajtimi i mbetjeve urbane të bëhen në vende legale, sepse sot, për hir të së vërtetës, vetëm 4 landfillle në shkallë vendi kanë leje urbane, gjithë të tjerët janë në pamundësi kushtesh minimale për t'u trajtuar si landfillle dhe për të marrë lejen mjedisore.

Pra me projektin ne do të zgjedhim 6 bashki, që nuk janë në masterplanet e mëdha, por që nëpërmjet projektit do të kenë ndihmë për t'u zgjidhur.

Ne do të fillojmë javën e ardhshme me miratimin e këtij projektligji në parlament, që të kemi mundësi që në mars këto fonde të jenë aktive dhe të kemi një investim të parë që do të përcaktohen nga ekspertët e projektit, në këto 6 bashki.

Ajo çfarë dua të theksoj, që i shkon edhe pyetjes së zotit Karamelo, është që për herë të parë në këtë marrëveshje ne kemi futur edhe investimet, pasi në përgjithësi GIZ-i nuk ka marr përsipër që të bëjë investime, por ka qenë gjithmonë në pjesën e menaxhimit, trajnimit,

forcimit të kapacitetit dhe krijimit të hapësirave. Pra për herë të parë marrin përsipër të bëjnë edhe investimin.

Më duhet ta ritheksoj, pasi zonja Gjermani e di shumë mirë, që mbështetja gjermane është e konsiderueshme në kuadër të trajtimit të mbetjeve urbane dhe mjedisit në përgjithësi, por ka një ndarje ndërmjet tyre, pra GIZ-i bën forcim kapacitetesh dhe ngritje strukturash, ndërsa KfV-ja është më e drejtpërdrejtë në investimet e qeverisë gjermane. Por për herë të parë GIZ-i pranon të ndërhyjë, pasi situata është e atillë që kërkon ndërhyrje të shpejtë.

Për sa i përket trajtimit të 61 bashkive, besoj se komisioni është i informuar, deputetët dhe qytetarët gjithashtu, që kemi bërë investime në disa landfille, si në Shkodër, i cili mbulon zonën Shkodrës dhe të Lezhës, kemi landfillin e Korçës që duhet të mbulojë të gjithë bashkitë e qarkut Plezhë, kemi do të zhvillohen edhe disa investime që në landfillin e Vlorës, për të mbuluar gjithë qarkun Vlorës, gjithashtu kemi landfillin e Bajkalit që mbledh dhe trajton mbetjet urbane të zonës së Gjirokastrës, zonës së sipërme të Himarës dhe të Sarandës. Qeveria shqiptare po investon në tri landfille të mëdha, në atë të Sharrës, në Elbasan dhe në Fier. Këto investime të mëdha do të mbulojnë gjithë zonën e qyteteve përkatëse, duke e zgjidhur përfundimisht problemin e mbetjeve urbane në zonat e mëdha. Pastaj të gjitha bashkitë e nivelit të dytë dhe të tretë do të duhet të transferojnë mbetjet urbane në këto landfille të licencuara. Por që të ndodh ky proces, ka nevojë që bashkitë e nivelit të dytë të kenë situata tranzitore.

Këtu vjen edhe përgjigjja e kolegut Vasili për zonën e Prespës, e cila do të ketë një pikë grumbullimi tranzitore, ku të gjitha mbetjeve do t'u bëhet një ndarje dhe mbetjet që kanë nevojë për riciklim do të shkojnë në landfillin e Maliqit. Gjithashtu, për Bashkinë e Prespës është edhe një projekt tjetër i qeverisë gjermane, i cili është një investim shumë i madh nga qeveria gjermane nëpërmjet KfV-së. Ky projekt tashmë është aktiv dhe ka kaluar në fazën e implementimit të produkteve të tij, ku një nga produktet është edhe trajtimi i mbetjeve urbane për atë zonë. Pra shumë shpejt aty do të ketë një investim konkret që do ta zgjidhë problematikën në qytetin e Pustecit, ku do të ketë një pikë tranzitore në Pustec, por depozitim përfundimtar do të bëhet në landfillin e Korçës. Pra, këto janë problematika që do të zgjidhen një e nga një.

Për sa i përket pyetjes së zotit Fino, ky nuk është një proces që është punë e donatorëve, por ne kemi shumë nevojë të jetë një proces i drejtuar nga kryetarët e bashkive. Ne kemi ndërmarrë një reformë të madhe për sa i përket trajtimit të të gjithë sistemit mjedisor dhe për këtë unë kam qenë në një takim me kryetarët e bashkive për t'ua bërë të qartë, që në

bazë të ligjit kjo është një detyrë dhe obligim 100% i kryetarëve të bashkive, të cilët e kanë përgjegjësi personale trajtimin e mbetjeve urbane.

Sot në shkallë vendi ne kemi shumë problematika për sa i përket trajtimit dhe depozitimit të mbetjeve urbane në të gjitha bashkitë. Prandaj ka ardhur koha që kjo të mos tolerohet më dhe, gjithashtu, të ketë zgjidhje konkrete. Pra, këto investime do të përfshijnë 6 bashkitë që ne po flasim. Gjithashtu, projekti zviceran zgjidh problemat për sa i përket rikuperimit të landfilleve që janë në qarkun e Beratit. Pra investimet janë ndërmarrë në shkallë vendi, por edhe koperacioni austriak dhe ai zviceran janë duke trajtuar këto problematika. Ne kemi pasur negociata edhe në Bashkimin European, që, në radhë të parë, 61 bashkitë e vendit të kenë mundësi që brenda vitit 2020 të kenë një zgjidhje ligjore, për sa i përket trajtimit të mbetjeve urbane, por edhe me investime dhe donacione të ardhura nga tre partnerët, pra buxheti i bashkive, buxheti i shtetit dhe donatorë të ndryshëm të këtij procesi.

Edhe në kuadër të projektit të “Shqipërisë turistike” është shumë e nevojshme që të kemi një trajtim tjetër ligjor, ku bashkitë e të gjitha niveleve të depozitojnë mbetjet urbane.

Mimi Kodheli – Fjala për zotin Hyseni.

Alket Hyseni – Zoti Ministër, faleminderit që jeni sot këtu!

Unë jam i interesuar për landfillin e Bajkalit, meqenëse përfshihet edhe Saranda. Ju jeni në dijeni që ky landfill ka një problematikë të akumuluar në vite, i cili është projektuar nga Banka Botërore për një sasi minimale prej 40 mijë tonësh mbetjesh urbane, ndërkohë që akumulohen rreth 12 – 13 mijë tonë në vit, kjo gjë e bën atë ineficient. Banka Botërore ka parashikuar 26 dollarë për ton për tarifën e akumulimit të mbetjeve nga landfilli, ndërsa sot, për një sasi shumë më të vogël, tarifa është 15 dollarë për ton, gjë që e bën totalisht ineficient. Qenia e këtij landfilli në varësi të këshillit të qarkut e bën të pamundur financimin apo mbushjen e këtij hendeku nga ky organ, i cili nuk ka financa. Unë nuk përmenda fare problemet teknike që ka ky landfill, difektet teknike që në projektim, zbatim, të cilat edhe pse janë përpjekur të arnohen gjatë rrugës, përsëri ka problematika. Pra në kuadër të këtij projekti, a mund ta parashikoni të gjithë këtë situatë të landfillit të Bajkalit?

Problemi i tretë është: ju po bëni një projekt në Himarë, gjë që e përjashton edhe Bashkinë e Himarës nga akumulimi dhe kjo gjë do të sjellë edhe më pak sasi të mbetjeve në këtë landfill. Nëse keni dijeni, mund të më jepni ndonjë shpjegim. Këtë e kam edhe në formën e pyetjes dhe në formën e kërkesës që, nëse nuk keni ndonjë gjë konkrete, në kuadër të këtij projekti apo të një projekti tjetër, të parashikohet patjetër zgjidhja e problematikës së mbartur në këtë landfill.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, ka të bëjë pikërisht me këtë marrëveshje. Zoti Fino, po nuk pati me këtë marrëveshje me kë do të ketë? Është Bashkia e Sarandës që trajtohet në këtë landfill.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë mund ta bëj sqarimin edhe me ju kur të doni, por unë e kam me ministrin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me këtë marrëveshje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Që të sqaroheni edhe ju, ministri do ta na japë një shpjegimin se çfarë do të ndodhë me Bashkinë e Sarandës me këtë marrëveshje.

Mimi Kodheli – Zoti Hyseni, të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket Hyseni – Ky është konteksti i pyetjes dhe shqetësimit tim. E para, është kënaqësi që kam ministrin e linjës këtu. Së dyti, është një debat që involvon problemin e mbetjeve. Më mirë se ky rast nuk më vjen më, zoti Fino. Mua më vjen keq që marr kohën tuaj dhe të kolegëve, por unë do ta bëj këtë, sepse votuesit e mi më kanë kërkuar që të ngre zërin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse Lushnja do të ishte parashikuar në këtë marrëveshje, mund ta kërkonte.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Epo nuk e thua dot.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E ke gabim, sepse është Saranda në këtë projekt.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e dëgjove mirë, është Saranda.

Faleminderit, zonja kryetare dhe ju kërkoj ndjesë për ilaritetin e kolegëve, por e kanë nga dashuria.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Hyseni!

Unë dua t'ju kujtoj që ministri së bashku me zëvendësministrin në orën 12:00 duhen të jenë në mbledhje qeverie, prandaj përfitoj nga rasti t'i bëj dy pyetje ministrit. A keni parashikuar në buxhet shumën prej 145 mijë eurosh TVSH, e cila, bazuar në marrëveshje, ju lind detyrimi ta keni?

E dyta, e kuptoj zonën e Himarës dhe të Roskovecit, të cilat kanë sipërfaqe, popullsi dhe konsum të madh, po përse edhe Rrogozhinën, edhe Peqinin në të njëjtën kohë, kur janë pak a shumë nga e njëjta zonë, në një kohë që mund të trajtoheshin më vete shumë njësi të vogla administrative? Nuk di nëse ka ndonjë interes të shtuar të deputetit që përfaqëson

Rrogozhinën, i cili ka një pozicion të rëndësishëm apo ka një arsye tjetër, si një situatë të rëndë mjedisore dhe ndotjeje atje.

E treta, nëse mundeni një fjalë ku kemi mbetur me projektin e landfillit të madh të dhënë me PPP-të në Fier?

Blendi Klosi – Faleminderit, kolegë deputetë!

Besoj se zoti Hyseni do të më kuptojë me xhentilesën për t'iu përgjigjur pyetjes tuaj, si kryetare dhe si zonjë. Besoj se do ta kemi mirëkuptimin?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e dyshoja këtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E nderuara zonja kryetare, për sa i përket pyetjes suaj në kuadër të përcaktimit të 6 bashkive, me të cilat qeveria gjermane ose koperacioni GIZ-i ka një marrëveshje të firmosur në një periudhë mbi 10 vjet dhe nuk besoj se ka lidhje me deputetin aktual të Rrogozhinës, nuk e di kush ka qenë përpara 10 vjetësh deputet i Rrogozhinës, projekti është në vazhdim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po. Dakord, janë të trajtuar nga projekti pothuajse prej një dekade.

Ndërsa për sa i përket Himarës, ajo ka qenë, por kemi futur edhe Sarandën...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Himara ka qenë, ndërkohë me kërkesën tonë kemi shtuar edhe Sarandën për të qenë edhe ajo një zonë bregdetare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kështu ka qenë edhe ndarja ndërmjet donatorëve. Projekti “Bashki të forta” që vjen nga Koperacioni Zviceran prej më shumë se 15 vjetësh. Unë personalisht, e mbaj mend prej shumë vjetësh që ekziston ky projekt, i cili ka ndihmuar bashkitë e Veriut, kurse projekti gjerman ka ndihmuar bashkitë e Shqipërisë së Mesme. Pra, ka një dakordësi në grupin e donatorëve dhe partnerëve të institucionit të ministrisë për sa u përket zonave që mbulojmë. Për sa i përket landfill-it të Fierit, që është pjesë e këtij diskutimi, po marr si shembull Bashkinë e Roskovecit, e cila nuk mund të ketë investime për të pasur një landfill të vetin, ndaj, siç e thashë, mbetjet urbane të Bashkisë Roskovec duhet të trajtohen në landfill-in e Fierit, i cili tashmë ka marrë edhe lejen mjedisore për të grumbulluar mbetjet urbane. Kështu, teorikisht të gjitha mbetjet urbane të 7 bashkive të qarkut Fier duhet të shkojnë në landfill-in e Fierit. Për sa u përket mundësive, kapaciteteve, parave që do të shpenzojmë bashkitë për të bërë këtë transportim, këtë gjë duhet ta diskutojmë me bashkitë, pasi është shumë problematike. Prandaj, sic e thashë pak më parë, është e nevojshme që të ketë një vend

transiti ose një vend grumbullimi transit dhe më pas të shkojnë në këto bashki. Kjo është zgjidhja edhe për të gjithë qarkun e Tiranës dhe për të gjithë qarkun e Elbasanit. Pra, kemi landfill-e të investuara nga qeveria shqiptare, të cilat janë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, në Roskovec duhet të ketë një vend transit, ku të bëhet ndarja e mbetjeve urbane nga mbetjet e reciklueshme, që kanë të bëjnë me mbetjet plastike dhe të gjitha mbetjet e tjera, gjithashtu edhe mbetjet inerte.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtë e bën landfill-i, por rritet kostoja, pasi transporti nga Roskoveci në landfill-in e Fierit ka kosto. Unë këtu dua të dal te pyetja e zotit Hyseni, sepse është e njëjta problematikë që ka edhe landfill-i i Bajkanit, pra kostoja e transportit për të gjitha mbetjet është shumë e lartë, pra mbetjeve inerte, mbetjeve urbane dhe mbetjeve të reciklueshme. Prandaj, bashkitë janë të lutura që të bëjnë ndarjet e tyre në burim, në vendet transitore, dhe mbetjet inerte të përdoren nga bashkitë përkatëse për nevojat e saj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në shumicën e rasteve e bën këtë gjë, pra asiston 6 bashkitë që të kenë zgjidhjet e tyre, por, siç e thashë, janë zgjidhje që duhet të mbulohen shumë nga buxheti i bashkive dhe më pas në landfill-in e Fierit shkojnë mbetjet urbane, të cilat, me investimin që po realizohet për incenerim, do të incenerohen në landfill-in përkatës të Fierit. E gjithë zona e qarkut të Fierit ka një dakordësi dhe një kontratë që mbetjet e 7 bashkive duhet të shkojnë atje. Kjo gjë ndodh edhe për mbetjet urbane të Tiranës dhe Durrësit, të cilat duhet të shkojnë në landfill-in e Sharrës, që është investimi më i madh në këtë aspekt. Pra, kjo është zgjidhja ideale.

Po i kthehem pyetjes së deputetit Sinaj, që ka të bëjë me landfill-in e Bajkanit. Është e vërtetë që përlllogaritjet bëhen në masë të konsiderueshme të gabuara, sepse pothuajse të gjitha bashkitë nuk e implementojnë vendimin e Këshillit të Ministrave që ka të bëjë me vlerësimin e koston së tarifës. Pra, në kuadër të një inercie shumëvjeçare koston e përlllogaritura nga bashkitë janë të fryra, pasi kanë të bëjnë me pastrimin e qytetit dhe nuk kanë të bëjnë shumë me landfill-et dhe me trajtimin dhe, kur këto kosto përlllogariten kur shkojnë në landfill, ne vëmë re se ka shumë më pak se sa bashkia mendon se do të prodhojë, për të mos thënë gjëra të tjera, por le të mbetemi këtu. Prandaj, kur këto mbetje shkojnë dhe peshohen në të gjitha landfill-et, kuptojmë se ka një mënyrë llogaritjeje të gabuar nga bashkitë. Prandaj, ne do të kishim një përplasje të fortë me bashkitë për të zbatuar vendimin e kosto-tarifave, por ndodhi kjo historia e tërmetit. Kjo gjë ka të bëjë edhe me bashkinë dhe landfill-in e Bajkanit, ku, për shembull, Bashkia e Himarës duhet t'i depozitojë mbetjet

urbane atje. Vitin e kaluar projekti (ne së bashku kemi qenë deputetë), ka marrë 720 kosha dhe po ashtu investime për të bërë këtë pikën transitore në zonën e Pilurit për të shkuar më pas në Bajkan. Dua t'ju kujtoj që për një bashki të vogël, siç është Bashkia e Himarës, është pothuajse e pamundur dhe inefficente, që të merren mbetjet urbane nga qyteti i Himarës apo të gjitha zonat përreth, pra nga Dhërmiu, nga Palasi apo zona të tjera dhe t'i çojnë në Bajkan, që është 120 kilometra larg. Pra, një makinë me mbetje urbane të pandara në zonat rurale duhet të bënte 100 kilometra vajtje dhe 100 kilometra ardhje. Himara para dy vjetësh kishte vetëm 2 makina dhe projekti i mundësoi 6 makina, madje edhe kosha, edhe kushte. Besoj se Himara ka pasur një performancë shumë më të mirë për trajtimin e mbetjeve urbane. Kjo nuk do të thotë se mbetjet e fundit urbane nuk do të shkojnë në Bajkan, por duhet të ketë këtë sistem dhe për këtë projekti ka ndihmuar shumë. Falë këtij projekti, besoj se kjo gjë do të bëhet në sezonin e ardhshëm edhe në Sarandë. Besoj se ne do të jemi këtu së bashku për ta ndjekur më në detaje këtë projekt, ku do të investohet shumë më tepër për kosha, për trajtim në publik, për mjete të transportit, të cilat i kanë shumë të nevojshme në dhe të gjitha bashkitë e bregdetit gjatë sezonit turistik, si Himara, Saranda, Durrësi apo Vlora, të cilat e kanë pothuajse të pamundur që me taksat e 10 mijë banorëve që ka Himara të mbulojë 200 mijë pushues, të cilët shkojnë në sezonin veror. Prandaj, ky projekt përpiket të asistojë këtë pjesë, duke ju kujtuar edhe një herë se ky është një projekt që asiston bashkitë dhe ka shumë pak dimension të investimit, por është më tepër në zgjidhjen e këtyre problemeve që ju thashë.

Për sa i përket pyetjes që bëri kryetarja, është e vërtetë që kërkohet kosto lokale dhe shteti shqiptar bie dakord me këtë. Kjo kosto lokale nuk do të jetë vetëm për vitin e parë, por është e shtrirë në 3 vjet. Në vitin e parë ne do të mbulojmë një pjesë të koston lokale, e cila është në kuadër të buxhetit të shtetit, por, duke menduar që projekti do të fillojë në muajt mars-prill, ne kemi shpresë se do të na japë mundësinë që gjatë periudhës së dytë të vitit 2020 të mbulojë një pjesë të kostove lokale për t'ia lënë një pjesë ngarkesës së dy vjetëve në vazhdim të zbatimit të projektit.

Mimi Kodheli – Zoti Ministër, shumë shkurt, ju lutem. A është më e drejtë që ju si ministri të mund t'i standardizoni kostot e ndarjes së hedhurinave, mbeturinave, dhe në këtë mënyrë të lehtësoni pushtetin lokal nga njëra anë dhe, sigurisht, t'i asistoni ata? Unë nuk po them të abuzojnë, por standardizimi i kostove, i shpenzimeve në këtë rast bën të mundur që të llogariten nga çdo bashki, pa qenë nevoja që të mund të shtohen kostot ose shpenzimet e panevojshme. A nuk mendoni se kjo është më e drejtë të bëhet nga ana e ministrisë?

Bledi Klosi – Është e vërtetë dhe vitin e kaluar ne kemi kaluar një vendim të Këshillit të Ministrave që standardizon dhe përcakton formulën që duhet të ndjekin të gjitha bashkitë

për sa i përket përlogaritjes së kostos: pse një bashki harxhon X lekë, si trajtohen mbetjet, transporti, konsumi, vendi afër apo larg, sa fshatra janë? Kjo nuk ndodh në të gjitha bashkitë, por 10 nga 61 bashkitë e zbatojnë këtë vendim të Këshillit të Ministrave. Siç e thashë, ne kishim përplasje të forta, besoj se e keni ndjekur një debat të madh ndërmjet ministrisë dhe bashkive për këtë aspekt për ta implementuar atë me detyrim dhe për të nxjerrë më pas koston reale të çdo bashkie. Kështu, përlogaritja e kësaj kostoje do të jetë më shumë transparente, natyrisht më pas, duhet të shkojmë te qytetarët për të diskutuar për tarifën. Në 61 bashkitë e vendit pothuajse kemi 61 tarifa të ndryshme për sa i përket mbulesës që i bëjnë qytetarët, por vendimi ekziston.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Ministër!

Unë besoj se ne i morëm përgjigjet për të gjitha paqartësitë tona.

Tani është koha për ta hedhur në votim.

Kush është dakord në parim me marrëveshjen? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nën për nen.

Neni 1. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit, zoti Ministër!

Ju uroj të gjithëve punë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.12.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për programin e shkëmbimit akademik “Fulbright”.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Ralf Gjoni, Vasil Sterjovski, Andrea Marto, Ligoraq Karamelo, Ediola Braha, Zef Shtjefni, Eglandina Gjermani, Adnor Shameti, Halit Valteri, Reme Lala, Evis Kushi, Ervin Bushati, Bashkim Fino dhe Xhemal Qefalia

Mungojnë:

Vasilika Hysi, Elona Hoxha, Rudina Hajdari, Ditmir Bushati dhe Fatmir Velaj.

Të ftuar:

Kostandin Shkurti - Zëvendësministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Erzen Tola - Drejtor i Përgjithshëm Rregullator dhe i Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Mimi Kodheli – Kalojmë në diskutimin e projektligjit të dytë.

Ju lutem, kolegë, unë e di që kjo mbledhje jashtë rendit të ditës krijon ilaritetin e saj, por do t'ju lutesha të respektojmë të ftuarit.

Zoti Zëvendësministër, keni lejen të shkoni në mbledhjen e qeverisë për të përfaqësuar ministrinë, meqenëse ministri nuk ka mundësi të jetë prezent. Sekretari i Përgjithshëm është këtu prezent.

Zoti zëvendësministër, jeni i lutur të largoheni.

Faleminderit!

Vazhdojmë me diskutimin e projektligjit “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për programin e shkëmbimit akademik “Fulbright”.

Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi.

I pranishëm është drejtori i Përgjithshëm Rregullator dhe i Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë, zoti Tola. Meqenëse zëvendësministrit i dhamë leje për të shkuar në mbledhjen e qeverisë, zoti Tola fjala është për ju për të na paraqitur në mënyrë shteruese se për çfarë flet programi i shkëmbimit “*Fulbright*”.

Erzen Tola – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me iniciativë të ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ka negociuar dhe ka hartuar memorandumin e mirëkuptimit ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për programin “Fulbright”. Ky memorandum është miratuar në parim me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 627, datë 23.09.2019. Ky memorandum u nënshkrua në SHBA ndërmjet dy palëve dhe pas nënshkrimit, bazuar në nenin 121 të Kushtetutës, duke qenë se Republika e Shqipërisë merr angazhim financiar, është paraqitur ky memorandum në Kuvendin e Shqipërisë për ratifikim. Projektligji përbëhet nga dy nene, në nenin e parë përcaktohet ratifikimi i memorandumit dhe në nenin e dytë hyrja në fuqi e tij.

Me anë të këtij memorandumit palët bien dakord për zbatimin e programit të shkëmbimit akademik “Fulbright” në arsim, kulturë, shkencë dhe kërkim, me qëllim realizimin e përfitimeve akademike të ndërsjella ndërmjet palëve.

Ky memorandum mirëkuptimi vjen si iniciativë e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Tiranë, iniciativë, e cila ka filluar në fund të vitit 2000, por deri në këto momente nuk ka pasur një marrëveshje të nënshkruar me SHBA-të për këtë program.

Programi “Fulbright” u themelua në vitin 1945 dhe mbështet shkëmbimet arsimore që forcojnë mirëkuptimin dhe komunikimin mes Shteteve të Bashkuara dhe mbi 155 vendeve në mbarë botën dhe tani edhe vendi ynë bëhet pjesë e këtij programi nëpërmjet kësaj marrëveshjeje.

Programi “Fulbright” ka siguruar më shumë se 286 mijë aplikues dhe kërkues, nga të cilët 46 mijë studentë kanë qenë nga Shtetet e Bashkuara dhe 150 mijë studentë të tjerë nga vendet e tjera të botës.

Miratimi i këtij projektakti do të sjellë efekte financiare në shumën prej 150 mijë eurosh për çdo vit akademik, duke filluar nga viti akademik 2019-2020 deri në vitin akademik 2024-2025. Pra, parimisht marrëveshja është nënshkruar për 5 vjet akademike me të drejtë rinovimi, bazuar mbi ecurinë e marrëveshjes, ndërsa shkëmbimi për Republikën e Shqipërisë do të fillojë nga viti akademik 2020-2021. Shkurtimisht këtë parashikon marrëveshja.

I ftoj deputetët ta votojnë këtë marrëveshje.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Tola.

A ka pyetje nga kolegët?

Unë kam një pyetje dhe më pas do t’ia kaloj fjalën zonjës Gjermani për një koment. Lidhur me transparencën, si mendoni që ky program do ta ndihmojë publikun dhe ne të interesuarit, përfaqësues të tij? Cili do të ishte ai elementi i transparencës që do ta bënte të besueshëm këtë program?

Erzen Tola - Sikurse është përcaktuar edhe në tekstin e kësaj marrëveshjeje, komisioni i cili do të shqyrtojë aplikimet dhe kërkesat do të ngrihet pranë Ambasadës Amerikane, ku Republika e Shqipërisë ka një përfaqësues të Ministrisë së Arsimit në këtë komision. Besoj se procedurat e këtij komisioni do të jenë publike dhe shumë transparente, pasi do të shqyrtohen nga komisioni i posaçëm që do të ngrihet pranë Ambasadës Amerikane.

Zonja Gjermani, fjala për ju.

Eglantina Gjermani - Faleminderit, kryetare!

Faleminderit, zoti drejtor, për prezantimin!

Më vjen shumë mirë që i gjithë bashkëpunimi historik në fakt i programit “Fulbright” tashmë bëhet me një marrëveshje dhe doja vetëm të shprehja konsideratën dhe vlerësimin maksimal për këtë program dhe ata që kanë qenë pjesë e tij duke dhënë një

kontribut të jashtëzakonshëm për zhvillimin e vendit. Them se tashmë, që jemi me një marrëveshje më institucionale, besoj se mundësitë do të jenë më të mëdha edhe për të nxitur dhe për të inkurajuar sidomos studiues të rinj apo ekspertë të rinj apo profesionistë të rinj, të cilët marrin një përvojë edhe e sjellin në Shqipëri. Kështu që ju ftoj të gjithë kolegët ta miratojmë.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Zoti Qefalia, fjala për ju.

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, unë kam një pyetje konkrete: a ka një numër limit ose tavan të përcaktuar se sa do të konkurrojnë dhe do të pranohen nga Shqipëria?

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Po, zoti Tola.

Erzen Tola – Në memorandumin e mirëkuptimit ishte e pamundur, bazuar në negocimet që kemi bërë me Ambasadën Amerikane, për të përcaktuar një numër limit, pasi ky numër mund të jetë i ndryshueshëm në vite të ndryshme akademike, bazuar në mundësitë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe në kërkesat që mund të ketë Ministria e Arsimit për fushat që kanë interes studimi. Nuk ka as minimum dhe as tavan për numrin e pjesëmarrësve, është lënë e hapur, kurse modalitetet e tjera do të përcaktohen në një nënmarrëveshje që do të nënshkruhet ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Institutit të Studimeve, bazuar në këtë memorandum.

Mimi Kodheli – Po, profesoreshë Kushi.

Më pas fjala për zotin Marto.

Evis Kushi – Faleminderit, kryetare!

Pa diskutim e vlerësoj marrëveshjen dhe besoj se të gjithë jemi dakord. Unë kam një pyetje që lidhet me këto bursa, sepse është e qartë që këto veprojnë edhe në anë të kundërt, pra jo vetëm studentët shqiptarë apo kërkues shqiptarë mund të shkojnë jashtë shteti dhe të kthehen në Amerikë, por kjo marrëveshje funksionon edhe në krahun e kundërt që dhe studiues nga Amerika, profesorë apo studentë duhet të vijnë në Shqipëri, sidomos në këto momente kur ne kemi shumë universitete apo institucione kërkimore-shkencore në gjuhë të huaj, pra që japin mësim në gjuhë të huaj. A ka raste të tilla, pra a ka raste që studiues amerikanë apo profesorë amerikanë vijnë në kuadër të këtij programi? A ka përpjekje nga pala shqiptare për t'i nxitur ata që të vijnë, sepse do të ishte shumë mirë që në këto institucione arsimore, në këto universitete, ku jepet mësim në gjuhën angleze ne të kemi edhe profesorë që janë anglishtfolës dhe profesorë nga Amerika? Pra, a përpjekje në lidhje me

këtë drejtim? Sa është numri aktualisht dhe çfarë përpjekjesh ka për t'i nxitur këto bashkëpunime?

Mimi Kodheli – Po, zoti Marto.

Andrea Marto – Unë thjesht dua të pyes nëse ka ndonjë vlerësim Ministria e Arsimit se është numri i përfituesve deri tani nga programi “Fulbright”, sepse ne kishim një eksperiencë disavjeçare? Këta që kanë përfituar janë duke performuar, duke ndihmuar Shqipërinë, apo kanë emigruar?

Mimi Kodheli – Drejtor, fjala për ju.

Erzen Tola - Atëherë, lidhur me pyetjen e parë për profesorët shtetas amerikanë që mund të vijnë në Shqipëri, mund të them se kjo është përpjekja e parë nëpërmjet së cilës ne synojmë që t'i ftojme dhe të kërkojmë që të vijnë edhe në kuadër të këtij programi profesorë amerikanë në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, sikurse kemi edhe pretendimet ose qëllimet tona për të çuar studiues shqiptarë në Amerikë. Kjo marrëveshje pikërisht këtë parashikon shkëmbimin e studiuesve dhe kërkuesve...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sigurisht, kjo është baza ligjore për nxitjen dhe pritshmëria është shumë madhe në kuadër të këtij memorandumit që të ndodhë.

Lidhur me përfituesit, sigurisht që ka pasur shumë përfitues që nga vitet 2000 deri në vitin 2016, por deri tani ne nuk kemi pasur një marrëveshje ligjore të nënshkruar me SHBA-të. Numrin e saktë nuk mund t'ju them, por, sigurisht, që ka shumë, madje ka edhe deputetë që kanë ndjekur programin “Fulbright” dhe që kanë dhënë shumë kontribute në Republikën e Shqipërisë.

(Diskutime pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Ne shpresojmë që pas ratifikimit të marrëveshjes të mund të ketë një *database*, e cila gjurmon të gjithë përfituesit, të cilët kontribuojnë, pasi mbarojnë shkollën, në Shqipëri.

(Diskutime pa mikrofon)

Tani është koha për ta hedhur në votim.

Kush është dakord me marrëveshjen? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nën për nen.

Neni 1. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Punë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.12.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2018 për projektin “Programi për infrastrukturën komunale V”.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Ralf Gjoni, Vasil Sterjovski, Andrea Marto, Ligoraq Karamelo, Ediola Braha, Zef Shtjefni, Eglandina Gjermeni, Adnor Shameti, Halit Valteri, Reme Lala, Evis Kushi, Ervin Bushati, Bashkim Fino dhe Xhemal Qefalia

Mungojnë:

Vasilika Hysi, Elona Hoxha, Rudina Hajdari, Ditmir Bushati dhe Fatmir Velaj.

Të ftuar:

Jovan Gjika - Drejtor i Projekteve të KfW-së

Lindita Sotiri - Drejtoreshë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Mimi Kodheli – Kalojmë në diskutimin projektligjit të tretë “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2018 për projektin “Programi për infrastrukturën komunale V”.

Të ftuar për këtë projektligj kemi zotin Jovan Gjika, drejtor i Projekteve të KfW-së, si dhe zonjen Lindita Sotiri, drejtoreshë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Mirë se keni ardhur!

Zonja Sotiri, fjala për ju.

Lindita Sotiri - Faleminderit, e nderuar kryetare!

Marrëveshja, në fakt, u paraprin marrëveshjeve financiare që priten të nënshkruhen pas miratimit të marrëveshjes qeveritare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë.

Në fakt, programi për infrastrukturën bashkiake V, përveç mbështetjes së qeverisë gjermane, e cila është ndarë në një mbështetje kredie prej 80 milionë eurosh dhe në dy grante, njëra për asistencën teknike të 3 milionë eurove dhe tjetra për investime kapitale, por që gjithsesi janë grante në një vlerë prej 6 milionë eurosh, kësaj shifre në total do t’i shtohet edhe mbështetja e BE-së dhe Republikës Federale Zvicerane. Mbështetja në total do të shkojë në 130 milionë euro. “Infrastruktura bashkiake V” është në vijim të “Infrastrukturës bashkiake 1 deri në 4” ku edhe metodologjia e implementimit do të vijojë të jetë e njëjtë, edhe në bazë të rezultateve të suksesshme që kemi pasur në 4 fazat e para. Vetë implementimi i marrëveshjes dhe i mbështetjes në terren do të ndahet në dy faza, ku faza e parë konsiston jo vetëm në hartimin e studimit të fizibilitetit, por në sigurimin e qëndrueshmërisë financiare të shoqërive dhe të qëndrueshmërisë totale dhe ofrimit të shërbimeve të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve, ku në fund të fazës së parë, pasi shikohet performanca e tyre, bëhet një auditim i pavarur, i cili kontaktohet nga financuesi dhe vetëm nëse janë realizuar ato kushte për të cilat është rënë dakord nëpërmjet bashkive dhe shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve dhe financuesit vijohet me investimin kapital. Faza e parë është në përfundim dhe janë duke u përfunduar printet. Maksimumi brenda janarit, për shkak edhe të kësaj periudhës së emergjencave, përfundojnë studimet e fizibilitetit, ndërkohë që faza e implementimit pritet të përfundojë brenda vitit 2025.

Jemi fokusuar në 11 qytete ku një pjesë janë të rikthyera nga faza e parë dhe e dytë, si Fieri dhe Lezha, ndërkohë që një pjesë vijohet me mbështetjen ku është përfunduar rrjeti i ujësjellësit me kanalizime dhe me impiante, siç është rasti Berat-Kuçovë dhe i Fierit, ndërkohë që kemi edhe dy qytete të reja të prezantuara në “Infrastrukturën bashkiake V”, që

janë Vlora dhe Elbasani. Në total nga “Infrastruktura bashkiake I deri në IV” është arritur që të ndikohet drejtpërdrejt në përmirësimin e ndjeshëm të furnizimit me ujë për 300 mijë qytetarë në mënyrë indirekte duke rritur cilësinë e shërbimit për 200 mijë të tjerë. Janë instaluar rreth 30 mijë ujëmatës dhe kemi një rrjet të shtuar ujësjellësi prej 635 kilometrash. Ajo që është e rëndësishme për ne si përfaqësues të ministrisë dhe të Agjencisë Kombëtare të Infrastrukturës dhe Mbetjeve, është se edhe në infrastrukturën bashkiake, duke qenë se është një nga mbështetjet më të mëdha financiare që vjen në sektorin e ujit, targetohet për t’u ndikuar në mënyrë cilësore përmirësimi i furnizimit me ujë për 300 mijë qytetarë të tjerë.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Po, zoti Gjoni, fjala për ju.

Ralf Gjoni - Duke kërkuar edhe mirëkuptimin dhe duke iu kërkuar ndjesë kolegëve për pakujdesinë time të mëparshme, që nuk e kam zakon por isha shumë i fokusuar te ky projektligj dhe ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e di pse instinktivisht pyetja shkoi te zoti Klosi.

Zonja drejtoreshë, unë, në fakt, do të doja shumë të informohesha dhe besoj edhe kolegët gjithashtu. Çfarë ka ndodhur konkretisht në mënyrë të prekshme me fazat e mëparshme të projektit, sidomos në këto qytete, pra po e përsëris pyetjen që bëra më parë, konkretisht në Berat, Kuçovë, Gjirokastrë, Kamzë dhe Lushnjë, si dhe në Lezhë, Fier dhe Sarandë gjatë fazës 1 dhe 2? A ka ndonjë arsye pse nuk është përzgjedhur Tirana, sepse kryeqyteti ka problematika kaq të mëdha me ujin e pijshëm, por nuk është i përfshirë në këtë projekt? A ka ndonjë plan në të ardhmen për të prekur zonat e kryeqytetit?

Faleminderit!

Mimi Kodheli - Po, zoti Sterjovski për pyetje.

Vasil Sterjovski – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë në fillim dua të shprehem se e mbështes këtë marrëveshje dhe duhet faktikisht të vlerësojmë edhe punën që kanë kryer Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Agjencia Kombëtare e Ujësjellës- Kanalizimeve për punën që ka bërë me sektorin e ujësjellës-kanalizimeve në vitet e fundit. Vërtet VKM-ja nr. 63 e datës 27 janar 2016 “Për organizimin në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve” ka dhënë rezultatet pozitive. Kjo duket edhe nga performanca e shoqërive që edhe shoqëritë e reja që janë krijuar, edhe nga të dhënat që i tha zonja Sotiri, sigurisht, ky sektor kërkon edhe mbështetje financiare. Është një nga sektorët më të vështirë, sidomos në linjat e paligjshme është shumë e vështirë edhe t’i

gjesh, sepse kanë vite që janë krijuar dhe janë nën tokë, por vërtet është për t'u përshëndetur puna që është bërë, sidomos në vitet e fundit në sektorin ujësjellësve. Unë, faktikisht, kam edhe një kërkesë për Ministrinë dhe Njësinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve lidhur me Bashkinë Pustec, sepse Bashkia e Pustecit është një bashkitë më të vogla në vendin tonë, siç e përmenda kur ishte edhe ministri Klosi, është një bashki që shtrihet buzë liqenit të Prespës dhe e gjithë zona është park kombëtar, është zonë turistike, por vuan mungesën e ujësjellësit si dhe të kanalizimeve. Në këta 30 vjetët e fundit nuk është investuar asgjë nga asnjë qeveri dhe është lënë pas dore. E gjitha bashkia ka 9 fshatra nga të cilat vetëm 2 fshatra kanë shërbimin e ujësjellësit dhe 2 fshatra të tjera shërbimin kanalizimeve. Gjithashtu, me detyrimin që ka lindur me VKM-në e datës 27 janar 2016 bashkia ka krijuar edhe shoqërinë e ujësjellës-kanalizimeve, por nuk mund të presim performancë nga kjo shoqëri, sepse numri i klientëve është shumë i vogël, 700 klientë ka kjo shoqëri. Mua më vjen keq që nuk është përfshirë kjo shoqëri edhe nga ministria dhe AKUM-i për të rritur performancën e saj. Ajo që duhet bërë janë investimet direkte në ujësjellës dhe kanalizime. Ndoshta me një shumë prej 1 milion eurosh mund të zgjidhet pjesa më e madhe e këtyre problemeve, sidomos për punë e ujit të pijshëm, se normale problematikat e ujësjellësit në vendin tonë duhen miliarda për t'i rregulluar për të pasur 24 orë ujë, por në këtë zonë me 1 milion euro besoj se pjesa më e madhe mund të zgjidhet. Unë kam një kërkesë që në planet tuaja të përfshini edhe Bashkinë e Pustecit.

Faleminderit!

Mimi Kodheli - Po, zonja Gjermani.

Më pas fjalën e ka zoti Marto.

Eglantina Gjermani – Shumë faleminderit për prezantimin!

Faleminderit, në fakt, i gjithë ky financim i qeverisë gjermane është historik, do të thosha, sidomos në fushën e infrastrukturës dhe ujësjellësve.

Unë lexova edhe te relacioni, por edhe atë që thatë ju, që janë dy bashki që ju thatë se rikthehen, Lezha dhe një qytet tjetër, megjithëse kanë qenë në fazën e parë, apo jo, apo thjesht nuk janë përfunduar?

Gjithsesi, vlerësoj shumë faktin që ju e përmendët që shoqëritë e bashkive, që realisht kanë realizuar atë pjesën e financimit apo të fondeve kanë mbledhur të ardhura aq sa duhet ju i financoni për ujësjellësin, në qoftë se kuptova mirë? Edhe kjo më duket shumë pozitive, por a keni një hartë ku do të vazhdoni të operoni tani për vitin 2020 dhe në vazhdim? Sigurisht, edhe unë, si të gjithë deputetë, jam e interesuar në mënyrë specifike për zonën ku jam zgjedhur, por gjëja tjetër, që kam merak është nëse tani me rishikimin e buxhetit a do të

keni ndonjë ngushtim? A do të vazhdojë puna për ujësjellësin? Ne kemi nevojë për ujë të pijshëm në të gjitha zonat, jo vetëm në zonat turistike. Ndoshta nuk mund të ketë ujë të pijshëm 24 orë, por po kërkojmë këtë gjë ende në vitin 2020 dhe duhet finalizuar. A do të ndikojë rishikimi i buxhetit në punën tuaj? Shpresojmë të mos shkurtohen fondet për ujësjellësin, pasi besoj se janë të domosdoshme.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Fjalën e ka deputeti Marto dhe më pas deputeti Shtjefni.

Andrea Marto – Faleminderit!

Duke qenë se ka një periudhë të gjatë kohe që donatorët dhe qeveria kanë dhënë fonde dhe i kanë kushtuar kujdes të veçantë ujësjellës-kanalizimeve: a kemi ndonjë statistikë sa nga shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve kanë performancë ekonomike pozitive me riorganizimin pas reformës territoriale?

Mimi Kodheli – Zoti Shtjefni.

Zef Shtjefni – Faleminderit, zonja kryetare!

Ralfi e preku këtë çështje, por dua të ndalem në Bashkinë e Kamzës, pasi kam qenë nënkryetar bashkie. Si ka ecur ky projekt, pasi janë disa faza që përmenden, lagjet 1, 2, 3, 4, të cilat nuk i di saktë, pasi jam larguar prej vitesh, por dua të di konkretisht, sepse ka qenë një nga bashkitë e para?

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Fjala për ju, zonjë.

Lindita Sotiri – Faleminderit!

Do të filloj me pyetjen e deputetit Gjoni.

Duke pasur parasysh që ju e parashtruat pyetjen në pjesën e parë, u mundova ta mbuloja në relacion. Ne mund të ndalojmë në çdo qytetet, por në makro, që e kemi si ministri, nga faza e parë deri në fazën e katërt dhe është ndërhyrë në qytete të caktuara, duke pasur fokus kryesisht tek ujësjellësi, kemi shtuar 135 kilometër linjë, kemi furnizim me ujë 24 orë.

Mund të përmendim Gjirokastrën, ku një pjesë e qytetit tashmë është përfunduar. Me përfundimin e fazës 3 dhe 4, që është në proces të përfundimit të punimeve, sigurohet furnizimi me ujë 24 orë edhe për pjesën e mbetur të qytetit; janë instaluar mbi 30 mijë matës; janë ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë duke siguruar furnizimin me ujë për 300 mijë qytetarë dhe në mënyrë të tërthortë duke iu përmirësuar sasia e furnizimit me ujë mbi 200 mijë qytetarëve. Në fakt, me këta financues kemi pasur ndër vite histori suksesi, ku kreditë e buta të marra kanë rezultuar pozitive edhe për shkak të metodologjisë, me të cilën është

implementuar kredia e marrë. Pra, nuk janë thjesht investime që shkojnë, por do të vazhdojmë edhe me kreditë e buta dhe me grantet që japim. Do të bëhet një studim fizibiliteti, ku do të vendosen target e caktuara në shoqëritë përkatëse dhe nëse rriten, do të vazhdohet me investimin. Në të kundërt, përtej asaj që prezantojmë sot për qytetet, mund të ndodhë që pas fazës së parë, që përfundon në janar, ndonjë prej tyre të mos bëhet i ligjshëm për ta përthithur investimin. Kështu kemi arritur edhe t'i nxisim ato të sigurojnë qëndrueshmërinë financiare, por, nga ana tjetër, të sigurojmë financimin, që të jetë i qëndrueshëm.

Për sa i përket pyetjes së deputetit Sterjovski ...

Ralf Gjoni – Në fakt, unë bëra një pyetje për Tiranën.

Për ta kompletuar pyetjen: pse qytetarët e Tiranës tarifohen për ujë të pijshëm, ndërkohë që nuk kemi ujë të pijshëm në shtëpi?

Lindita Sotiri – Ndjesë për pjesën e Tiranës.

Për sa i përket Bashkisë së Tiranë, nuk është pjesë e infrastrukturës bashkiake 5, sepse, së pari, edhe për shkak të performancës së mirë financiare, e cila, për fat të keq, nuk ndihet direkt në rritjen e ndjeshme dhe të qenësishme të furnizimit me ujë, sepse ka nevojë për kohën e vetë dhe mbulon një pjesë të madhe të investimeve me financat e veta.

Gjithashtu, Bashkia e Tiranës është një nga shembujt e suksesit në kuptimin financiar, për sa kohë që është e vetmja shoqëri që ka arritur të negociojë së fundi me BERZH-in për marrjen e një kredie, diku në 30 milionë euro, pa garanci sovraane, të targetuar në Yzberisht, dhe është duke negociuar sërish për një kredi tjetër me BE-in, diku në 80 milionë euro.

Për pyetjen tuaj, pse nuk është pjesë e këtij programi, është sepse e ka siguruar financimin. Ka edhe një biznesplan, i cili parashikon ... E kuptoj që për të gjithë ne si qytetarë ndoshta nuk është lajmi më i mirë i mundshëm, por furnizimi me ujë 24 orë do të arrihet në 5 vjetët e ardhshëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk kanë kaluar. Megjithatë, ne mund ta vëmë në dispozicion planin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Zoti Gjoni, ju lutem!

Ralf Gjoni – Unë kam pyetjet e mia dhe do të replikoj.

Koleg i nderuar, nuk të marr leje për pyetjet dhe bashkëbisedimet që do të bëj me drejtoreshën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk je ti filtër dhe gjykatës. Të respektojmë njëri-tjetrin!

Unë do të bëj pyetjen time, si më intereson dhe si e shikoj unë.

Mimi Kodheli – Ju lutem!

(Diskutime pa mikrofon)

Zonja Sotiri, pavarësisht pyetjeve të kolegëve, unë ju ftoj që përgjigja juaj t'i përmbahet marrëveshjes që ne po flasim. Nëse ne do të kemi nevojë për një përgjigje më të zgjeruar për situatën aspak të këndshme të furnizimit me ujë të pijshëm të popullsisë në Republikën e Shqipërisë, do të ftojme ministrin e linjës, që të përgjigjet për këtë gjë.

Ralf Gjoni – Unë e mora përgjigjen.

Mimi Kodheli – Dakord.

Vazhdoni me përgjigjet për pyetjet e tjera.

Lindita Sotiri – Për sa i përket pyetjes së zonjës Gjermani, Fieri dhe Lezha rikthehen për kanalizime, sepse është realizuar mbështetja për furnizimin me ujë. Në Fier është parashikuar realizimi i impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura urbane.

Për sa i përket pyetjes së deputetit Sterjovski për Bashkinë e Pustecit, duke e konfirmuar edhe me kolegun Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve, në Bashkinë e Pustecit është bërë një vizitë e dedikuar për të parë potencialin për investim jo më larg se shtatori i këtij viti. Agjencia dhe ministria janë duke pritur shoqërinë e ujësjellës-kanalizimeve dhe bashkinë për të paraqitur projektin për financim. Pra, janë marrë të gjitha masat për t'u adresuar në të ardhmen, po pa projekt është e vështirë të realizojmë mbështetjen e nevojshme.

Për pyetjen e deputetit Marto, sa nga shoqëritë kanë performancë të kënaqshme, në fillim të reformës vetëm 4 shoqëri e mbulonin koston totale të operimit, por numri i tyre është shtuar. Me secilën prej bashkive ne kemi të dhëna të sakta për performancën e tyre ekonomike, sepse është viti i dytë që nënshkruhen kontrata performance, ku ka edhe një grant performance, ku shoqëritë që performojnë më mirë, me një skemë të hapur dhe transparente, bazuar në rezultatet e raportuara nga shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve, përfitojnë në nivelin e performancës. Tashmë kemi një pjesë relativisht të mirë të shoqërive. Sigurisht, kemi numrat që kanë performancë të mirë financiare. Kemi 14 shoqëri që mbulojnë koston e operimit dhe të mirëmbajtjes. Këto të dhëna nuk janë ato që do të donim, por një pjesë e pamundësisë për funksionimin e mirë të shoqërive, siç është rasti i Pustecit, është se janë të vogla. Një nga ndërhyrjet, që Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është duke tentuar ta implementojë, nëpërmjet ligjit që do të vijë gjatë sesionit të ardhshëm parlamentar, është agregimi i shoqërive, sepse me një shoqëri, e cila ka 700 konsumatorë, kostot janë tejet të larta. Sado e mirë të jetë performanca e drejtorit të lartë të shoqërisë së ujësjellës-kanalizimeve, është e pamundur teknikisht dhe financiarisht të sigurohet mbështetja.

Për sa i përket pyetjes së deputetit Shtjefni, Kamza ka qenë e përfshirë në infrastrukturën bashkiake 1. Ka qenë një nga shoqëritë që i ka realizuar të gjitha targetet dhe objektivat, dhe për këtë arsye ka marrë financim të vazhdueshëm. Në Kamëz vijon furnizimi me ujë. Ndërhjert kanë qenë në lagje të caktuara. Është një nga bashkitë që i ka pambushur kushtet për të vijuar financimin. Duket sikur janë pa fund, por ndërhyrja ka qenë në lagje të caktuara.

Faleminderit!

(Diskutime pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Zonja Gjermani, a keni pyetje që nuk keni marrë përgjigje?

Eglantina Gjermani – A do të ndikoheni apo do të vazhdojë puna normalisht për ujësjellësin në zonat ku do të operoni në vazhdim për faktin e shkurtimit të buxhetit?

Lindita Sotiri – Për zonat që përfshihen në vijim në kuadër të marrëveshjes që prezantojmë, kuptohet që ne kemi si synim 11 qytete, por finalizimi se ku do të jetë ndërhyrja do të shikohet pas auditimit të fazës së parë. Qeveria gjermane do të kontrakttojë një auditor të pavarur. Potencialisht ne shpresojmë të jetë 11, por nëse do të rezultojë se nuk i kanë plotësuar kushtet e para, do të jetë e pamundur, për fat të keq, për të vazhduar investimin në atë shoqëri.

Për sa i përket buxhetit, ne jemi të gjithë në pritje. Indikacionet e para janë që nuk do të preket fondi për ujësjellësit nga rishikimet e buxhetit. Në fakt, është mëse e domosdoshme, sepse përtej faktit që duket sikur investohet shumë në ujësjellës, ne kemi përmendur vazhdimisht, edhe në rastet e tjera, kur kemi sjellë projektligje të kësaj natyre, që nevoja për investime është 5 miliardë euro, falë edhe një analize që ka bërë donatori gjerman, ndërkohë që investimi në vite duhet të ishte 180 milionë euro. Në vitin më të mirë, që është viti i ardhshëm, që ne kemi parashikuar, do të shkojmë në 90 milionë euro. Pra, të shikojmë sa gep financiar kemi aktualisht, edhe pse i kemi rritur investimet në nivel historik, keni shkuar nga 50 në 90. Megjithatë, nevoja duhet të kishte qenë 180 milionë euro që nga viti 2011, që të kishim furnizim 24 orë me ujë, cilësinë e kanalizimeve dhe trajtimin e ujërave, për të cilën të gjithë jemi të interesuar. Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Kam një pyetje për KfW-në. Nga fillimi i aktivitetit të kësaj agjencie, deri më sot, nuk e di nëse ju jeni në dijeni të thoni se sa para janë shpenzuar në Shqipëri nga qeveria gjermane për këtë fushë.

(Ndërhjert pa mikrofon)

Të lutem, sepse nuk e kam mbaruar pyetjen. Nëse kolegu Bushati, që është njeri i statistikave, thotë: “Ralfi, kjo është 200 milionë”, ndërkohë nevojat janë vlerësuar deri në 180 milionë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

5 miliardë në vit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gjithsej 5 miliardë? Dakord.

Keni një raportim të saktë se çfarë nuk ka funksionuar me paratë që nuk janë shpenzuar? Sa nga projektet nuk funksionojnë siç duhet? A ka pasur abuzime me fondet? Që ka pasur, s’e diskutoj. Këtu nuk jemi për të bërë gjykatësin, por ka pasur abuzime. Kur mendoni se dy qytetet, Saranda dhe Lezha, për të cilat unë kam dijeni të hollësishme për sasinë e furnizimit me ujë të pijshëm, do të kenë ujë të pijshëm 24 orë? Është trishtim i madh që duke shkuar në qytetin turistik të Sarandës ti shikon vetëm ujë, burime, të bukura, të pafundme, por nuk ka ujë. Një qytet turistik si Lezha, nuk ka ujë. Deri në vitin 2013, kur unë jam zgjedhur deputete në atë zonë, kishte ujë vetëm 30 minuta në ditë. Ju jeni një brez shumë i ri, por ne na iku jeta duke dëshiruar të kemi ujë të rrjedhshëm. Përfundimisht, nuk kemi asnjë shpresë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo tregon se do të jetoj gjatë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë jam rritur duke u çuar në 3:00 të natës...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më rëntë pika mua!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kuptoj. KfW-ja të përgjigjet. E kam me ju, sepse qeverinë e kuptuam.

Jovan Gjika – Nga viti 1989, kur ka filluar bashkëpunimi gjerman, në të gjithë sektorët në Shqipëri janë investuar mbi 1 miliard euro. Në sektorin e ujit janë investuar mbi 350 milionë euro investime kapitale dhe qytetet që kanë përfituar të parat kanë qenë Kukësi, Hasi, Kavaja dhe Rrogozhina. Në vitin 1994 ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, i shtohet edhe kjo.

Në këto 4 qytete ka pasur projekte të emergjencës në atë kohë. Më pas, qyteti që ka përfituar financim të plotë, ujësjellës-kanalizime dhe impiante-trajtim ujërash, është Korça, me investim të konsiderueshëm mbi 60 milionë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Impianti i trajtimit të ujërave të përdorura, që shkarkon ujëra të pastra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Korça dhe ujësjellësi 24 orë. Pra, që nga viti 2004 Korça ka 24 orë ujë, për qytetin flasin, dhe ujërat e zeza i ka në operim bashkë e impiantit që nga viti 2013.

Pogradeci ka përfituar në vitin 2007 ujin e pijshëm dhe që nga viti 2013 ka impiant për trajtimin e ujërave të zeza.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E ka. Unë jam nga Pogradeci dhe të garantoj që e ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I gjithë qyteti furnizohet me impiant. Një pjesë të fshatit Starovë dhe Sdërvacka po i përfshijmë tani me një pjesë të buxhetit të shtetit, në kuadër të bashkëpunimit me fondin amerikan, që po bën pjesën e Tushemishtit dhe të Drilonit. Presim projektin nga bashkia, që ta financojmë në vitin 2020 dhe ta mbyllim edhe për këto.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lezha ka 24 orë ujë në qytet që nga viti 2017. Këtë ta garantoj me kokë. Është bërë në kuadër të fazës 1, që pyeti deputeti Gjoni. Lezha është sot një nga dy ndërmarrjet që performojnë më mirë në rang Republike.

Në kuadër të sistemit të monitorimit, Saranda ka përfituar investime nga faza 1 e këtij programi, por vetëm në 60% të qytetit. Pra, zona midis rrugëve 1 dhe 4 ka rrjet të ri ujësjellësi. Zona e Kodrës ka rrjet të ri ujësjellësi. Zona mbi kuotën e rrugës 4, rruga 5, për Sarandën, nuk arrihet ujësjellësi, por ka pasur një financim të Fondit Shqiptar të Zhvillimeve me fondin e zhvillimeve të rajoneve, që është në mes dhe duhet ta vazhdojnë për ta përmbyllur investimin e tyre. Zona turistike ka rrjet të ri ujësjellësi të bërë 70% nga faza 1 e KfW-së dhe Banka Botërore. Saranda ka në operim impiantit e ujërave të zeza të bërë nga Banka Botërore që prej 3 vjetësh. Ksamili dhe Saranda kanë rrjetin e kanalizimeve, që i çojnë në impiant. Në Sarandë mbeten vetëm kanalizimet e pjesës së portit për t'u lidhur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në Shëngjin kemi impiantit e Lezhës, që i mbledh të dyja, edhe Lezhën, edhe Shëngjinin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është në funksion, por ka një problem, që depozitohet rërë më shumë nga projektimi. Depozitimi i rërës në vaskën e trajtimit biologjik nuk jep efektin e pritshëm të trajtimit

biologjik. Në kuadër të këtij programi ne po marrim masa shtesë, që të gjitha stacionet e Shëngjinit të kenë grila.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në impiant do të fuqizojmë paratrajtimin, sepse nuk është projektuar i tillë me kushte europiane. Do të bëjmë paratrajtimin, trajtimin mekanik; sedimentimin e rërës do ta përforcojmë me dyfish kapacitetin, që kur të hyjë biologjiku, të mos e depozitojnë në vaskë, por të trajtohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse ka pasur, ka pasur bashkë me gjermanët, por ka një filtër shumë të fortë kontrolli, që ...

Mimi Kodheli – Të falënderoj për pasqyrimin dhe për punën!

Mendoj ta hedhim në votim.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit, kolegë për prezencën dhe për sqarimet!

Mbledhje tjetër nuk do të kemi. Do të shihemi në seancë.

MBYLLET MBLEDHJA